



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 160/2 Prot.

Tiranë, më 08.02.2022

V E N D I M

Nr. 34, Datë 08 .02 .2022

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (*në vijim Komisioneri*), bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 16, datë 24.01.2022, të paraqitur nga ankuesi Dh.K (*në vijim ankuesi*) kundër Qendrës Kombëtare të Biznesit (*në vijim QKB*) në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes shoqërore*”, “*aftësisë së kufizuar*” dhe “*çdo shkak tjetër*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesi prashtron se, është administrator i kompanisë K. sh.p.k. Ai pretendon se është diskriminuar nga QKB për shkak se nuk shikon dhe nuk ka qenë i informuar mbi ligjin që kishte dalë dhe afatet ligjore. Sipas tij, QKB nuk e ka informuar me shkresë zyrtare në lidhje me përgjegjësitë e subjektit K. sh.p.k, në rast se ky subjekt nuk bënte regjistrimin e pronarit përfitues, sipas detyrimit të parashikuar nga ligji i ri që kishte dalë.

Si administrator i K. sh.p.k dhe për shkak se nuk shikon, ankuesi deklaroi se nuk ka patur dijeni për detyrimin e ri ligjor për regjistrimin e pronarit përfitues. Menjëherë sapo ka marrë dijeni nga rrethi shoqëror që ka dalë një ligj i ri, që duhet të regjistronte pronarin përfitues, ka aplikuar për t’u pajisur me nënshkrimin elektronik dhe në momentin që është pajisur me nënshkrimin elektronik ka bërë aplikimin për të raportuar pranë QKB-së pronarin përfitues. Ankuesi deklaroi se është ortaku i vetëm i kompanisë, por edhe administratori i kompanisë, pra është vetëidentifikuar si pronari i kompanisë.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri, anulimin e vendimit të kundravajtjes administrative, të aplikimit me numër çështje RPP20220106133530633022331001, për subjektin K sh.p.k me NIPT xxxxxxxxxxx, pasi është diskriminues.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Bazuar në aktet e administruara ankuesi Dh.K, rezulton ortak i vetëm dhe administrator i Shoqërisë K. sh.p.k. Bazuar në të dhënat e ekstraktit historik të shoqërisë, të vendosur në dispozicion nga ankuesi, rezulton se, shoqëria K. sh.p.k, është regjistruar si person juridik në datë 25.10.2000, nga ankuesi, si ortak i vetëm.

Me vendimin e datës 06.01.2022, të QKB-së, subjekti K. sh.p.k dhe ankuesi Dh.K, administrator dhe përfaqësues ligjor i këtij subjekti, janë gjobitur në shumën totale 400.000 (katërqind mijë) lekë, nga të cilat 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë për subjektin dhe 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë për ankuesin në cilësinë e përfaqësuesit ligjor, bazuar në nenin 13, pika 2, 3, 4 të ligji nr.112/2020 “Për regjistrimin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar, për konsumimin e kundravajtjeve administrative të mëposhtme:

- Mospërmbushje e detyrimit të subjekteve raportuese ekzistuese për regjistrimin e të dhënave të kërkuara nga ky ligj brenda afatit të përaktuar në pikën 3, të nenit 15 të këtij ligji, përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë në vlerën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë;
- Mosregjistrim i të dhënave sipas pikës 3 të nenit 15 të këtij ligji, përbën kundravajtje administrative për përfaqësuesin ligjor të subjektit të regjistruar, person juridik dhe dënohet me gjobë prej 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Ankuesi pretendon se, nuk ka patur dijeni për detyrimet ligjore të vendosura nga ligji i sipërituar, për shkak se nuk shikon. Sipas raportit mjekësor datë 02.11.2021, të lëshuar nga znj. M.M, kirurge oftamologe, pranë Spitalit Amerikan, të depozituar nga ankuesi, rezulton se ky i fundit ka humbur pamjen si pasojë e traumës në femini dhe në kontrollin mjekësor të datës 2.11.2021, situata e tij është vlerësuar, në OD “*Phtysis bulbi. Visus O. Hypotoni*”, ndërsa në OS “*Status post-operatione multiple për shkolitje retine. Glaukoma sekondare. PNO atrofike. Visus PL T.io 10+5mmHg (sipas pakimetrisë) me mjekim. Pseudofakia. IOL me fiksion skleral, e deentruar, turbullime mbi IOL. Retina atrofike. Periferia e trajtuar me kryo/laser. Vasat retinale filiforme*”

Ankuesi ka depozituar ankesën pranë Komisionerit duke pretenduar se është diskriminuar, për shkak të gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar dhe “çdo shkak tjetër”, nga ana e QKB, për shkak të gjobitjes për kundravajtjet administrative të sipërituara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “ç” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) shfuqizuar; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para

komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; **c) është haptazi e pabazuar** ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijoni për sjelljen diskriminuese”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është haptazi e pabazuar, bazuar në arsyetimin vijues:

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe të sigurojë mbrojtje efektive nga diskriminimi.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë shkaqet e pretenduara nga ankuesi, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me raën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen ivile, vendbanimin, **gjendjen shëndetësore**, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, **aftësinë e kufizuar**, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përaktohet si : “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferenë, bazuar në ilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Ankuesi pretendon se, vendimi i QKB për gjobitjen e tij për kundravajtjet administrative të parashikuara nga ligji nr.112/2020 “Për regjistrimin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar e ka diskriminuar pasi ai nuk ka patur dijeni për detyrimet e vendosura nga ligji, për shkak se nuk shikon. Pra, çështja që shtrohet në rastin objekt shqyrtimi ka të bëjë me momentin e marrjes dijeni për të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga miratimi i ligjit.

Neni 117/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon se: “1. Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare.” Kushtetuta e lidh momentin e marrjes dijeni për ligjin, me botimin e tij në Fletore Zyrtare. Botimi i ligjit në Fletoren Zyrtare prezupozon marrjen dijeni për të drejtat dhe detyrimet ligjore për të gjithë.

Rezulton se, ligji nr.112/2020 “Për regjistrimin e pronarëve përfitues”, është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.149, datë 13.08.2020 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Afati për përmbushjen e detyrimeve të vendosura nga ligji nga ana e subjekteve raportuese ka qenë, jo më vonë se 60 ditë kalendarike nga krijimi i Regjistrin e Pronarëve Përfitues, i cili sipas ligjit krijohet brenda datës 31.01.2021.

Referuar nenit 1, të ligjit të sipërituar, subjektet raportuese që kanë detyrimin për të regjistruar pronarin përfitues janë : a) shoqëritë më përgjegjësi të kufizuar; b) shoqëritë aksionare;) shoqëritë kolektive; ç) shoqëritë komandite; d) zyrat e përfaqësimit dhe degët e shoqërive të huaja; dh) shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre; e) shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë; ë) shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor; f) çdo subjekt tjetër juridik, i ili me ligj detyrohet të regjistrohet pranë QKB-së; g) organizatat jofitimprurëse, ku përfshihen fondaionet, shoqatat, qendrat, si dhe degët e organizatave jofitimprurëse të huaja, të regjistruara në regjistrin e organizatave jofitimprurëse në Republikën e Shqipërisë; gj) personat juridikë dhe ndërmarrjet, aksionarët e të ilëve, përveç institucioneve qendrore dhe/ose vendore të Republikës së Shqipërisë, janë edhe individë/persona juridikë të tjerë shqiptarë dhe/ose të huaj.

Sa më sipër Shoqëria K. sh.p.k me ortak të vetëm dhe administrator ankuesin Dh.K, është subjekt raportues dhe duhet të përmbushë detyrimet ligjore për raportim sipas mënyrës dhe afateve të përaktuara nga ligji.

Me Aktin Normativ me fuqinë e ligjit, Nr. 12, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 112/2020 “Për regjistrimin e pronarëve përfitues”, ndër të tjera është miratuar shtyrja e afatit kohor për raportimin e pronarit përfitues nga ana e subjekteve raportuese, deri në datën 30.06.2021. Akti Normativ ka hyrë në fuqi menjëherë dhe është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.49, datë 29.3.2021. Akti Normativ Nr.12, datë 25.3.2021, i Këshillit të Ministrave është miratuar nga Kuvendi me ligjin nr.55/2021 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 12, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 112/2020, “Për regjistrimin e pronarëve përfitues”, i cili është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.83, datë 01.06.2021.

Hyrja në fuqi e ligjit apo marrja dijëni nga ana e subjekteve mbi të ilat vendosen detyrimet e ligji, nuk kushtëzohet nga detyrimi i QKB, për të njoftuar me individualisht subjektet e ligjit.

Sa më sipër, Komisioneri nuk konstaton sjellje të padrejtë nga ana e QKB, në raport me pretendimet e ngritura nga ana e ankuesit, pasi QKB nuk ka asnjë detyrim për të njoftuar individualisht subjektet e ligjit lidhur me detyrimet e tyre. Sipas parashikimeve kushtetuese, ankuesi ka marrë dijëni për detyrimet ligjore që nga momenti i botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “ç”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga ankuesi Dh.K, nuk mund të pranohet pasi është haptazi e pabazuar dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet proedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, gërma “ç” të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr. 16 regj., datë 24.01.2022, të paraqitur nga ankuesi Dh.K kundër Qendrës Kombëtare të Biznesit.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku : Aftësia e kufizuar, gjendja shëndetësore

Fusha: Shërbime

Lloji i vendimit: Mospranim